REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.7.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm (ose Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm), Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Kapllan Muhaxheri (Udhëheqës i ekipit), Donjetë Dreshaj, Mirlinda Beqiri dhe Laureta Matoshi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia 8

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 9

3 Rekomandimet e vitit paraprak 12

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 13

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 37

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak 40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2013, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Ministrin dhe ekipin e tij për ndihmën e dhënë gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 22.11.2013.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Vjetore të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit të datës 22.11.2013;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga Menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë.

Opinioni

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *theksim i çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në lidhje me pasuritë fikse dhe stoqet e barnave janë materialisht të pasakta.

(**ISSAI 200: Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes**).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për raportim, draft pasqyrat e paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Disa janë ndryshuar në versionin final të pasqyrave, por menaxhmenti zgjodhi ti linte disa zëra të pakorrigjuara. Si pasojë informatat e shpalosura në Pasqyrat Vjetore Financiare, rreth pasurive dhe stoqeve nuk ishin të sakta;
- Katër nga tetëmbëdhjetë rekomandimet e vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme janë adresuar në nivel qëndror mirëpo \nuk janë implementuar ende në gjithë sektorin e shëndetsisë. Kjo ka rezultuar me përseritje të disa dobësive nga vitet e kaluara;
- Menaxhimi joefikas i projekteve kapitale ka ndikuar që niveli i realizimit të buxhetit të planifikuar për këtë kategori të jetë i dobët;
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerrë në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur te menaxhimi jo i mirë i projekteve kapitale dhe subvencioneve në rastin trajtimeve të pacienteve jashtë institucioneve publike shëndetësore; tek menaxhimi i barnave; të hyrat; menaxhimi i pasurisë si dhe menaxhimi dhe prezantimi i detyrimeve. Poashtu për shkak të numrit të limituar të auditorëve, jo të gjitha fushat e veprimtarisë janë mbuluar me auditim të brendshëm dhe kjo e ka zvogëluar sigurinë e ofruar menaxhmentit rreth funksionimit të sistemeve financiare kyçe për vitin 2013.

Rekomandimet e dhëna në ketë raport i janë drejtuar Ministrit. Duke marrë parasysh reforma në sektorin shëndetësor është thelbësore që Ministri të siguron se ky raport është shpërndarë dhe i diskutuar brenda strukturës së përgjithshme të menaxhimit në këtë sektor. Më tej, kontrollet dhe barazimet duhet të themelohen brenda sektorit kur bëhet strukturimi dhe specifikimi i përgjegjësive brenda Institucioneve. Duke bërë këtë, rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm duhet të merren në konsideratë. Gjithashtu kontratat e performancës me drejtuesit e rinj duhet gjithashtu, përveq kërkesave të përgjithshme të rezultateve, të vendosen masa që duhen ndërmarrë ne lidhje me rekomandimet.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Ministri duhet të sigurojë që:

- Të analizohen arsyet për mungesën e regjistrit të plotë të pasurive dhe mbivlerësimin e stoqeve të barnave në pasqyrat financiare,si dhe mos zbatimin e kështillave të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm gjatë fazës së përkohëshme të auditimit. Duhet të zhvillohen procese adekuate që sigurojnë evidenca të plota rreth pasurive dhe stoqeve dhe paraqitje të saktë të tyre në Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2014.

- Në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave, përpara se ato të dërgohen në Ministrinë e Financave, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;

- Plani i veprimit, i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm me Institucione të përgjegjshme dhe stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme në mënyrë qe të përmirësohet funksionimi i kontrolleve të brendshme dhe menaxhimi financiar;

- Të monitorojë performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e duhura të ekzekutimit të buxhetit. Planifikimet buxhetore duhet ti marrin në konsideratë të gjitha burimet e fondeve duke përfshi edhe donacionet;

- Të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të evidentimit dhe raportimit i cili ofron informata të sakta dhe në kohë për të hyrat; respektimin e tarifave të aprovuara gjatë procesit të dhënies së licencave për punë; dhe të shtohen masat e veprimit në mbledhjen me kohë të të hyrave nga qiraja;

- Të implementojë një rishikim të rasteve të identifikuara për të vlerësuar pse mallrat nuk janë liferuar sipas kushteve të kontraktuara, pasojat e kësaj dhe masat adekuate për të siguruar që këto dobësi janë adresuar. Një qasje e tillë duhet të zbatohet edhe për shmangien e klasifikimit të gabuar të shpenzimeve. Poashtu duhet të sigurohet mbikqyrje adekuate e realizimit të kontratave;

- Në afat sa më të shkurtër të bëhet plotësimi i pozitave udhëheqëse me staf të angazhuar me kontrata të rregullta. Kjo duhet të bëhet përmes procedurave të hapura publike. Të bëjë një rishikim të kontratave mbi vepër për të siguruar arsyeshmërinë e tyre dhe pajtueshmërinë me dispozitat ligjore, si dhe të përcaktojë masat dhe veprimet e nevojshme që sigurojnë menaxhim efikas të detyrave dhe proceseve specifike në kuadër të Ministrisë;

- Të rishikoj çështjen e funksionimit dhe pagesave të bordeve dhe komisioneve, në mënyrë që të përcaktohen masat e nevojshme për shmangien e pagesave të paarsyeshme. Të gjitha masat e propozuara duhet të jenë në harmoni me ligjet e aplikueshme dhe me synimet afatgjata të Ministrisë;

- Të shfrytëzohen të gjitha kapacitetet aktuale dhe të zhvillohen kapacitete të reja në kuadër të Institucioneve shëndetësore publike për trajtimin e sëmundjeve që aktualisht trajtohën jashtë këtyre institucioneve. Kjo do të ndikoj në zvogëlim të kostove të këtyre shërbimeve dhe në ngritjen e reputacionit të sistemit publik shëndetësor. Të konsiderohet mundësia e adaptimit të një udhëzuesi të brendshëm/qarkore në lidhje me trajtimet jashtë institucioneve publike shëndetësore, duke specifikuar qartë kushtet dhe kriteret mbi barazimet e rregullta financiare pas trajtimit të pacientëve;

- Të hartohen dhe aplikohen politika dhe procedura që sigurojnë një menaxhim dhe monitorim efikas të procesit të furnizimit me barna. Përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në këtë proces duhet të jenë të qarta për të mundësuar që procesi të jetë transparent dhe llogaridhënia të jetë në nivelin e duhur. Çdo hyrje dhe dalje e stokut duhet të evidentohet në Sistemin për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik. Praktika e pranimit të barnave me afat të shkurtë të qëndrueshmërisë duhet të ndërprehet me qëllim të zvogëlimit të kostove;

- Të siguroj që Komiteti i Auditimit në Ministri është plotësisht operacional në dhënien e asistencës në afat të shkurtër në adresimin e rekomandimeve nga auditorët. Në afat të mesëm Ministri duhet të marrë parasysh organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në pajtim me një nga opcionet e propozuara nga Auditori i Përgjishëm në Memorandumin "Funksionimi i auditimit të brendshëm në Sektorin e Shëndetsisë dhe nevojat për përshtatjën e reformave".

Përgjigja e Ministrit – Auditimi 2013

Ministri është pajtuar me të gjeturat dhe është zotuar se do ti adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) të përgatisë pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar te të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë raporti më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse te të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të e dorëzuara në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Cilësia e PVF-ve në përgjithësi ishte e mirë, ku u identifikuan një numër i vogël gabimesh jo materiale dhe të gjitha obligimet e raportimit ishin plotësuar. Obligimet tjera të raportimit që nuk kanë lidhje me PVF-të ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar[1] me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *theksim i çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në lidhje me pasuritë fikse dhe stoqet e barnave janë materialisht të pasakta. Kjo sipas SNKSP të bazuar në para të gatshme nuk ndikon në asnjërën nga dy pasqyrat financiare (Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme dhe raporti i ekzekutimit të buxhetit (**ISSAI 200: Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes**).

[1] Termi "opinion I pamodifikuar" është ekuivalent me termin "opinion I pakualifikuar" I përdorur në versionin paraprak të raportit të auditimit. Terminologjia e re është në pajtim me standardet e reja të INTOSAI-t. Për më shumë informacion referoju shtojcës I

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 22.11.2013, janë identifikuar dy (2) rreziqe domethënëse në PVF lidhur me plotësinë.

Rreziku 1- Rreziku i identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive, respektivisht mos harmonizimi i informatave të regjistrit të përgjithshëm të pasurive me regjistrat individual. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive të MSH-së, ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rrezikun e paraqitur.

Rreziku 2 - Rreziku është identifikuar në lidhje me saktësinë e regjistrave kontabël të stoqeve. Prezantimi i barnave me afat të skaduar në PVF ka rezultuar me mbivlerësim material të vlerës së stoqeve. Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rrezikun e paraqitur.

Çështja 1 – Regjistri jo i saktë i Pasurive dhe mbivlerësimi i stoqeve -Prioritet i lartë

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave rreth pasurive për vitin 2013. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që informatat për pasuritë në PVF të jenë të plota dhe të sakta. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë të pasakta.

Rekomandimi 1 **Prioritet i Lartë –** Ministri duhet ti analizojë arsyet për mungesën e regjistrit të plotë të pasurive dhe mbivlerësimin e stoqeve të barnave në PVF, dhe për mos zbatimin e këshillave të dhëna nga ZAP gjatë fazës së përkohëshme të auditimit. Duhet të zhvillohen proceset adekuate që sigurojnë evidenca të plota rreth pasurive dhe stoqeve si dhe paraqitje të saktë të tyre në PVF-të e vitit 2014.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare Nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048; dhe
- Kërkesat tjera relevante.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

MSH ka përmbushur obligimet e veta si Organizatë Buxhetore (OB) për raportimet që kërkohen në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi duke respektuar cilësinë, afatet dhe formën e duhur. Përveç hartimit të PVF-ve, MSH ka arritur të përbmushë edhe obligimet tjera si në vijim:

- Kërkesat buxhetore;
- Raportet mujore për detyrimet e papaguara;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit janë dorëzuar në Agjensioni Qendror i Prokurimit;
- Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të AP; dhe
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 23.12.2013 në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

MSH i kishte pranuar rekomandimet tona të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2012,duke i cilësuar si të dobishme për përmirësimin e menaxhimit të aktiviteteve të saj dhe cilësisë së raportimit. Menaxhmenti ishte zotuar se do të bëjë përpjekjet e nevojshme për adresimin e të gjitha çështjeve të ngritura. Megjithatë deri në përfundim të auditimit tonë të PVF-ve të vitit 2013 jo të gjitha rekomandimet ishin adresuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të MSH-së ka rezultuar me 18 rekomandime. MSH kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, shtatë rekomandime janë implementuar plotësisht; shtatë pjesërisht, dhe katër nuk janë implementuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht sepse Ministri nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të ZAP-it.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare kanë rezultuar në:

- Menaxhim jo të mirë të subvencioneve në rastin e trajtimeve të pacientëve jashtë institucioneve publike – shëndetësore;
- Mos menaxhim efikas i barnave;
- Klasifikim jo adekuat të shpenzimeve;
- Mos përmirësim të kontrolleve që ndërlidhen me të hyrat,
- Regjistër jo të plotë të pasurive;
- Prezentimi dhe shpalosje jo të plotë dhe të saktë të obligimeve të papaguara.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme në mënyrë qe të përmirësohet funksionimi i kontrolleve të brendshme dhe menaxhimi financiar.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar, kontroll efektiv dhe rezultate nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet ende nuk janë të dizajnuara mirë, nuk janë zbatuar siç është planifikuar dhe nuk funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim rigoroz të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, bazuar në planet reformuese të sektorit shëndetësor, duke përfshirë edhe rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e ndërmarrë në kuadër të MFP në lidhje me vetë-vlerësimin e KBFP, ku si pikënisje është fillimi i reformave dhe aprovimi i ligjeve të reja të sektorit të Shëndetësisë.

Ne kemi gjetur se kontrollet e menaxhimit të barnave dhe subvencionimit për trajtime të pacienteve jashtë institucioneve publike nuk po zbatohen në mënyrë efektive. Poashtu kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që ministria të ketë humbje financiare, dhe menaxhim jo efektiv. Përveq menaxhimit të barnave, fushat ku nevojiten më shumë përmirësime janë edhe: pagesat për borde dhe komisione që funksionojnë në kuadër të MSH-së; menaxhimi i të hyrave; menaxhimi i pasurisë; dhe menaxhimi dhe trajtimi i detyrimeve.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për MSH-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[2]	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	106,795,857	108,942,896	99,521,409	87,305,025	79,903,318
Granti i Qeverisë-Buxheti	102,841,877	103,405,935	95,373,804	82,714,458	76,188,739
Të bartura nga viti paraprak–	-	108,928	108,925	841,961	770,891
Të hyrat vetanake	3,953,980	3,953,980	3,577,059	3,720,719	2,314,617
Donacionet e jashtme	-	1,474,053	461,621	27,887	629,071

Burimet e fondeve buxhetore të MSH-së janë: Granti qeveritar; të hyrat vetanake; dhe donacionet e jashtme. Buxheti final ishte për 2,123,086€ më i lartë se ai fillestar.

Pjesa me e madhe e buxhetit ishte shpenzuar për: Kujdesin Dytësor Shëndetësor (Spitalet Rajonale), Kujdesin Tretësor Shëndetësor (QKUK, Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik etj) dhe Shërbimet Tjera Profesionale (Program Farmaceutik, Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore, AKPM etj).

[2] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	106,795,857	108,942,897	99,521,409	87,305,055	79,903,318
Pagat dhe Mëditjet	44,504,985	44,996,281	44,408,183	42,527,654	38,827,166
Mallrat dhe Shërbimet	42,488,799	40,587,024	38,332,671	29,167,678	29,418,681
Shërbimet komunale	3,502,073	3,601,973	3,388,643	3,871,063	3,292,171
Subvencionet dhe Transferet	3,000,000	4,775,563	4,763,602	2,841,184	2,206,483
Investimet Kapitale	13,300,000	14,982,056	8,628,310	8,897,476	6,158,817

Në vitin 2013 MSH ka përdorur 91% të buxhet final, me një përmirësim prej 11% krahasuar me vitin 2012.

Buxheti i pa shpenzuar në fund të vitit 2013 ishte 9,421,488€, prej tyre 1,012,432€ janë nga donacionet.

Një shfrytëzim më i vogël i mjeteve vërehet tek kategoria e investimeve kapitale ku janë shpenzuar vetëm 57% e buxhetit final. Kjo paraqet një performancë të dobët buxhetore. Edhe dinamika e shpenzimeve nga kjo kategori ishte në shpërputhje me planin, pasi vetëm në tremujorin e fundit të vitit janë shpenzuar 3,682,850€ ose 43% e shpenzimeve vjetore të kësaj kategorie.

Niveli i shpenzimeve tek kategoritë tjera ekonimike është i knaqshëm duke marrë parasysh edhe numrin e madh të njësive (programeve buxhetore) të MSH-së.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Te Hyrat vetjake	3,953,980	4,062,908	4,215,837	3,925,511	3,838,143
Totali	**3,953,980**	**4,062,908**	**4,215,837**	**3,925,511**	**3,838,143**

Të hyrat e gjeneruar nga MSH janë pjesë përbërëse e buxhetit të saj, dhe shfrytëzohen për mbulimin e kostove operative të MSH-së. Derisa ne vetëm një pjesë e vogël në vlerë prej 8,678€, ka shkuar në buxhetin e Kosovës.

Rekomandimi

Çështja 3 – Ekzekutimi i buxhetit – Prioritet i Lartë

E gjetura

Ekzekutimi i buxhetit në investimet kapitale vetëm 57% është i ngjashëm ndërmjet viteve dhe nxjerr në pah një nivel të vazhdueshëm të ekzekutimit të dobët të kësaj kategorie. Një nga arsyet për ketë është vendimi i Ministrisë së Financave për të stopuar të gjitha zotimet që nuk kishin urdhërblerje. Mirëpo edhe trendi i shpenzimeve në fundvit është i vazhdueshëm, me 71% të shpenzimeve në tre mujorin e fund vitit, të vitit 2013, dhe 65% në 2012 .

Poashtu vlera e madhe e donacioneve të pashpenzuara është sinjal se ky burim i fondeve nuk ishte menaxhuar mirë dhe nuk është marrë në konsideratë sa duhet nga MSH gjatë planifikimit të buxhetit.

Rreziku

Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i lartë i buxhetit në fund të vitit mund të rezultojë në pagesa pa kryerjen e punimeve; shërbime të kualitetit jo të duhur; mos arritje të objektivave të organizatës dhe financim të detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm. Mos përdorimi i donacioneve ulë efektivitetin dhe redukton potencialisht donacionet e tjera në ato fusha ku donatorët shohin përdorimin e dobët të fondeve të tyre

Rekomandimi 3

Ministri duhet të monitorojë performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Planifikimet buxhetore duhet ti marrin në konsideratë të gjitha burimet e fondeve duke përfshi edhe donacionet. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Kontrollet e aplikuara në procesin e menaxhimit te të hyrave ishin të dobëta. Harmonizimi i të hyrave është bërë në baza të rregullta mujore dhe tremujore mes MSH dhe Thesarit. Regjistrimi i të hyrave është bërë në kode përkatëse ekonomike. Megjithatë ekziston nevoja për përmirësim të aspektit të regjistrimit dhe raportimit për të mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së të hyrave Mungesa e një softueri për të hyrat në QKUK dhe në Spitalet Regjionale kishte ndikim në regjistrim dhe raportim të te hyrave me theks të veçantë të hyrat nga participimet.

Përshkrimi

MSH realizon të hyra nga: participimet e pacientëve; licencat e ndryshme për produkte mjekësore; qiraja e objekteve publike; tarifat nga parkingu; licencat individuale profesionale mjekësore dhe të institucioneve profesionale mjekësore vendore dhe ndërkombëtare; banderolat; çertifikatat mjekësore; gjobat nga inspektoratet; si dhe nga taksat tjera të ndryshme. Gjatë vitit 2013 ishin inkasuar të hyra në vlerë prej 4,207,159€. Testimet tona ishin të fokusuara në të hyrat nga participimet, të hyrat nga licencat për veprimtari shëndetësore, të hyrat nga parkingu dhe të hyrat nga banderolat dhe qiraja. Mostrat janë marrë në disa njësi të MSH-së si; Administrata Qendrore, QKUK, AKPM dhe në Spitalet Rajonale në Gjilan, Gjakovë edhe Prizren.

Rekomandimi

Çështja 4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave – Prioritet i lartë

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar mangesitë në vijim sa i përket fushës së të hyrave:

- Për të marrë apo vazhduar licencën, Institucionet shëndetësore obligohen të paguajnë tarifa (taksa administrative) të caktuara, dhe në rast të mos pagesës apo vonesës pagesës së kësteve në bazë të udhëzimeve parashihen edhe gjoba. Në pesë nga lëndët e auditura ne kemi vërejtur vonesa të pagesave të kësteve të taksës administrative të mbetur në emër të licencimit dhe nuk janë aplikuara gjobat e parapara për vonesat e tilla[3].

[3] Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2006/01 të MSH, Institucioni shëndetësor do të ndëshkohen me gjobë prej 200-1,000€, në rast të mosrespektimit të afatit për kryerjen e obligimeve me rastin e rilicencimit.

- Po ashtu në katër raste të testuara nuk ishin bërë fare pagesat në bazë të tarifave të përcaktuara, kurse institucionet shëndetësore ishin pajisur me licenca dhe zhvillojnë veprimtarinë në bazë të licencave të lëshuar nga MSH.
- SR në Gjilan kishte nënshkruar kontrata për dhënien me qira të lokaleve. Nga njëri operator nuk ishte inkasuar shuma e borxhit prej 5,000€. Këto kontrata nuk ishin transparente pasi që nuk ishin shfrytëzuar procedurat adekuate me rastin e dhënies në shfrytëzim si dhe kontratat nuk janë të nënshkruara nga menaxheri i prokurimit.
- Në SR në Gjilan në disa raste inkasantët nuk i kanë depozituar paratë e mbledhura nga parkingu në arkën e spitalit deri në 15 ditë edhe pse me vendim të Drejtorisë të Spitalit është precizuar se ato duhet të dorëzohen për çdo tri ditë.
- Në një rast në AKPM kemi vërejtur se operatori i cili ishte i furnizuar me Banderolla ka paguar me pak se sa ishte furnizuar me një diferencë prej 10,000 njësi/copë të banderollave.

Rreziku Informacioni aktual mbi të hyrat nuk është i saktë ose i plotë dhe nuk është në dispozicion në kohën e duhur për ta mbështetur vendim-marrjen e menaxhmentit. Evidencat e mangëta për të hyrat, shkaktojnë paqartësi rreth saktësisë së obligimeve dhe pagesave të bëra nga përfituesit e këtyre shërbimeve.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm i cili ofron informata të sakta dhe në kohë; të siguroj respektimin e tarifave të aprovuara gjatë procesit të dhënies së licencave për punë; dhe të shtohen masat e veprimit në mbledhjen me kohë të të hyrave nga qiraja.

4.4 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

MSH i kupton kërkesat e sistemeve të forta të kontrollit në këtë fushë. Pavarësisht kësaj, nevojitet zhvillim i mëtejmë në fushën e kontrolleve të menaxhimit të barnave; të subvencioneve; dhe investimeve kapitale. Si fusha specifike për përmirësim dhe zhvillim të mëtejmë të kontrolleve të brendshme mbeten menaxhimi stoqeve në depon qendrore të barnave, mosrealizimi me kohë i projekteve kapitale, pagesat e bordeve dhe komisioneve, klasifikimi i shpenzimeve dhe menaxhimi jo efektiv i avanseve për udhëtime zyrtare.

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në këtë kapitull janë përfshirë të gjitha prokurimet që ndërlidhen me investime kapitale dhe ato për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Për investime kapitale buxheti ishte 14,982,058€, prej të cilave janë shpenzuar 8,628,310€ apo vetëm 57% e buxhetit final. Derisa për mallra dhe shërbime ishin buxhetuar mjete prej 40,587,024€ (pa përfshirë shpenzimet komunale) dhe janë shpenzuar 38,332,671€ apo 94% e buxhetit.

Testimet tona janë fokusuar në ekzaminimin e procedurave të prokurimit si dhe pagesave që janë bërë për blerjet përmes prokurimit. Mostra ka përfshirë pagesa me vlerë të përbashkët prej rreth 2.4 milion euro. Rezultatet e testimeve dhe çështjet e evidentuara janë shpalosur në vazhdim:

Rekomandimet

Çështja 5 – dobësi sistematike në prokurim – Prioriteti - i lartë

E gjetura

Rishikimi ynë ka identifikuar dobësi të cilat kanë ndikim në dy e më shumë kontrata. Në veqanti ne kemi identifikuar:

Vonesa në liferimin e mallrave - Në SR Gjilan kishte vonesa të liferimit të pajisjeve dhe materialit shpenzues për ortopedi në vlerë prej 9,960 euro.Afati i liferimit ka qenë 28.06.2013 kurse malli është dorëzuar me dt. 4.07.2013;

Poashtu "Inventari Medicional Administrativ " në vlerë prej 9,965 ishte dashur të liferohet me datë 18/06/2013 derisa ishte pranuar me 04/07/2013.

Regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate – është identifikuar në rastet si më poshtë:

- Në QKUK pagesa prej 89,400€ është kryer nga kategoria e investimeve kapitale, ndërsa kishte të bëjë me trajnime të stafit që ndërlidhej me Funksionalizimin e Institutit të Onkologjisë;
- Pagesa në vlerë prej 9,628 euro është regjistruar si kapital tjetër nga kodi (31900) ndërsa ishte mirëmbajtje dhe servisim (14010);
- Blerja e 11 fotokopjeve ishte e regjistruar si pajisje nën 1,000€ edhe pse vlera e tyre për njësi ishte 3,550€;
- Pagesa në vlerë 5,772€, me përshkrimin "pajisje të teknologjisë informative", ishte bërë për pjesë rezervë të automjeteve (furnizim me drita emergjente sinjalizuese, altoparlant dhe foli xhami për automjete).

Përveq kësaj kishte edhe pagesa brenda kategorisë së njëjtë ekonomike por nga programet buxhetore jo të duhura. Në veqanti ne identifikuam:

Pesë pagesa me vlerë totale 105,598€, janë paguar për QKUK-në nga mjetet e planifikuara për "programe tjera" dhe shtatë pagesa me vlerë totale 86,105€ nga mjetet e AKPM-së, janë paguar për Entin Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut, pa transferim paraprak të mjeteve.

Rreziku Vonesat në liferimin e pajisjeve dhe materialit shpenzues ndikojnë në cilësinë e shërbimeve mjekësore. Pagesat nga kodet e gabuara ekonomike shkaktojnë pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve dhe është në kundërshtim me rregullat financiare. Pagesat nga departamentet jo adekuate rrezikojnë arritjen e objektivave specifike të departamenteve të cilave u meren mjetet.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të rishikoj rastet e identifikuara për të përcaktuar pse mallrat nuk janë dorëzuar në përputhje me kushtet kontraktuale, pasojat e saj dhe masat e duhura dhe të përshtatshme duhet të ndërmerren për të siguruar që këto dobësi janë adresuar. Qasja e njejtë duhet të zbatohet edhe për të shmangur keq klasifikimin e shpenzimeve

Çështja 6 – Dobësitë jo-sistematike në prokurim – Prioriteti i lartë

E gjetura Tek lënda "Renovimi i Aneksit të Energjencës" në QKUK kishte mospërputhje në mes të faturës, kontratës dhe raportit të mbikëqyrësit. Kompania mbikëqyrëse kishte prezantuar për pagesë një vlerë më të lartë se kontrata e nënshkruar, pagesat janë bërë në bazë të raportit të mbikëqyrësit. Mbipagesa ishte 6,885€. Sipas zyrtarëve përgjegjës kjo ishte një gabim teknik, ndërsa pas vërejtjes tonë kjo shumë i është ndalur OE në pagesën e faturës pasuese.

Tek kontrata me vlerë prej 96,159€ në SR Gjilan-parashihej që punimet të përfundojnë me 15/07/2015, dhe siguria e ekzekutimit duhet të jetë e vlefshme deri 30 ditë pas pranimit teknik. Derisa siguria e ekzekutimit e ofruar nga fituesi i tenderit ishte e vlefshme vetëm deri më 15/07/2014.

Rreziku Pagesat për pozicionet e pakryera, dhe me çmime me të larta se ato të kontraktuara, shkaktojnë kosto shtesë dhe të pa arsyeshme. Mungesa e vlefshmërisë së sigurisë së ekzekutimit rrit rrezikun e moskryerjes së kontratës apo kryerjes së punimeve me cilësi të dobët.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuar për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe masat e duhura për evitimin e tyre në te ardhmen. Në veqanti duhet të sigurohet mbikqyrje adekuate e realizimit të kontratave. Me qëllim të evitimit të humbjeve nga mos kryerja e punëve apo nga cilësia e dobët e punimeve nga operatorët, duhet të sigurohet që siguria ekzekutimit të mbulojë të gjithë periudhën e përcaktuar me kontratë.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Në këtë kapitull përfshihen shpenzimet e ndodhura që nuk kanë nevojë për zhvillim të procedurave të prokurimit. Megjithë funksionimin efektiv të kontrolleve në këtë fushë akoma ka vend për përmirësim të disa aspekteve.

Për testim kemi përzgjedhur 37 njësi mostre me vlerë totale158,037€. Rezultatet e testimeve janë shpalosur më poshtë:

Rekomandimet

Çështja 7 - Pagesat nga skema stimulative e përformancës pa dokumentim mbështetës – Prioriteti i mesëm

Gjatë vitit 2013, QKUK kishte shpenzuar 194,807€ nga skema stimulative e profesionisteve shëndetësor. Mirëpo nuk është ofruar dokumentacion relevant mbështetës në lidhje me "Vlërsimin e përfomancës së profesionistëve shëndetësorë", në bazë të kritereve për përmbushjen e standardeve dhe indikatorëve të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr 09/2013 ". Poashtu në listën e përfituesve kishte edhe zyrtar të cilët nuk janë të përcaktuar si përfitues në bazë të këtij udhëzimit administrativ.

Rreziku Kryerja e pagesave në mungesë të dëshmive, nuk ofron sigurinë e nevojshme për kryerjen e punës në bazë të marrëveshjeve relevante dhe udhëzimeve administrative në fuqi në lidhje me performancën. Këto poashtu mund të shkaktojnë kosto të pa nevojshme dhe të pa-arsyeshme për Ministrinë.

Rekomandimi 7 Ministri nëpermjet Agjencionit për Financimin Shëndetësor duhet të siguroj që pagesat për performancën e institucioneve dhe shërbyesve shëndetësor të bëhen konform udhëzimeve dhe marrëveshjeve të arritura. Monitorimi dhe vlerësimi i arritjes së përformancës duhet të bëhet në baza të rregullta mujore apo tremujore dhe vetëm pasi të dëshmohet se kriteret janë përmbushur të bëhen pagesat.

Çështja 8- Përzgjedhja e mbikëqyrësit të projektit pa procedura - Prioriteti i mesëm

E gjetura Tek lënda " Renovimi i sallës së lindjes dhe nyjeve sanitare" në SR Gjilan në vlerë prej 108,195€ përzgjedhja e mbikëqyrësit të projektit është bërë pa zhvilluar ndonjë procedurë paraprake të prokurimit;

Rreziku Përzgjedhja e mbikqyrësit në mungesë të konkurencës është jotransparente dhe në kundërshtim me normat ligjore. Kjo mund të shpie deri te pagesat e parregullta.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të siguroj që të gjitha institucionet shëndetësore do të aplikojnë procedurat adekuate me rastin e përzgjedhjes së shërbimeve të mbikqyrjes.

Çështja 9 - Avanset për udhëtime zyrtare - Prioriteti i mesëm

E gjetura Avanset për udhëtime zyrtare jashtë vendit nuk ishin mbyllur dhe arsyetuar brenda afatit ligjor. Vlera e avanseve të pa mbyllura në fund të vitit ishte 82,238€. Sipas PVF-ve, avanset e hapura rrjedhin nga vitet paraprake ku shuma e mjeteve prej 78,977€ janë avanse të viteve të kaluara të pa arsyetuara dhe ato të vitit 2013 ishin në vlerë 3,261€.

Rreziku Vonesat në mbylljen e avanseve rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve të pashpenzuara. Gjithashtu, kjo mund të krijojë dyshime nese këto fonde janë shfrytëzuar në mënyrë efikase dhe për qëllimin e pritur.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të siguroj që politikat dhe procedurat e aplikuara të mundësojnë rritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve me rastin e udhëtimeve zyrtare, duke dëshmuar dhe arsyetuar saktë shpenzimet e ndodhura dhe duke mbyllur me kohë avanset.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrim

Buxheti final për Paga dhe Mëditje për 2013 i ishte 44,996,281€, kurse janë shpenzuar 44,408,183€ apo rreth 99% e buxhetit. MSH për vitin 2013 kishte planifikuar 7,587 të punësuar, ndërsa kishte 7,441 të punësuar me orar të plotë, si dhe 265 të punësuar me orar të shkurtuar. Transferimi i të punësuareve nga Ministria e Drejtësisë gjatë vitit ka ndikuar në rritjen e të punësuareve aktual (Transferimi i Depertamentit të Burgjeve në kuadër të MSH). Kontrollet e aplikuara nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar funksionim efikas konsistent. Çështjet e identifikuara janë paraqitur më poshtë:

Rekomandimet

Çështja 10 - Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre në afat me të gjatë se 6 muaj– Prioritet i lartë

E gjetura	Sipas dispozitave ligjore, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet me gjatë se tre muaj. Në QKUK gjatë vitit 2013 janë mbuluar gjithsej 36 pozita me ushtrues detyre. Ku 32 prej tyre janë që nga 2012 si ushtrues detyre. Zyra e personelit gjatë vitit 2013 kishte shpallur dy herë konkurs, mirëpo ende nuk kishin arritur të përzgjedhin kandidatë të cilët do t'i mbulonin këto pozita.
Rreziku	Mbajtja e pozitave udhëheqëse nga ushtrues të detyrës për periudha të gjata është shkelje e dispozitave ligjore dhe mund rezultoj me performancë të dobët operacionale.
Rekomandimi 10	Ministri duhet të siguroj që në afatin sa më të shkurtër të bëhet plotësimi i pozitave udhëheqëse me staf të angazhuar me kontrata të rregullta. Kjo duhet të bëhet përmes procedurave të hapura publike.

Çështja 11 - Kontratat e punës dhe kompensimi i tyre – Prioriteti i lartë

E gjetura

Në 18 raste, MSH kishte nënshkruar kontrata të rregullta pune në pozita drejtuese me pagë sekondare dhe për kohë të pacaktuar. Derisa në memorandumin tri palësh të nënshkruar nga MSH, MF dhe MASHT, theksohej se zyrtarët që kanë dy kontrata të rregullta pune, nuk mund të ushtrojnë pozitën drejtuese me orar jo të plotë. Sipas shënimeve nga Payrolli kemi vërejtur se këta zyrtarët kanë kontratë të rregulltë pune me pagë primare edhe me një organizatë tjetër buxhetore.

Në QKUK në shtatë raste ishin lidhur kontrata mbi vepër (të përkohshme) në kohëzgjatje mbi 120 ditë dhe pa zhvilluar procedura konkuruese.

Rreziku

Mbajtja e pozitave drejtuese nga persona që kanë edhe marrëdhënie tjera të punës ndikon në cilësinë e menaxhimit të aktiviteteve dhe proceseve. Rrjedhimisht mund të ndikoj që objektivat e ministrisë të mos realizohën. Nënshkrimi i kontratave mbi vepër në mungesë të konkurencës përveq që është jo transparent dhe diskriminues ndaj kandidatëve potencial konkurrent, rrit rrezikun që të mos angazhohen personat adekuat.

Rekomandimi 11

Ministri duhet të bëjë një rishikim të kontratave të lartëpërmendura për të siguruar arsyeshmërinë e tyre dhe pajtueshmërinë me dispozitat ligjore, si dhe të përcaktojë masat dhe veprimet e nevojshme që sigurojnë menaxhim efikas të detyrave dhe proceseve specifike në kuadër të Ministrisë. Angazhimi i stafit për detyra specifike me kontrata mbi vepër duhet të bëhet vetëm kur është e domosdoshme dhe në bazë të procedurave konkurruese dhe transparente.

Çështja 12 -Pagesat për bordet dhe komisionet - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë vitit 2013, MSH kishte shpenzuar 230,360€ për pagesën e bordeve dhe komisioneve të ndryshme të themeluara me vendime të Ministrit. Në kemi vërejtur se një anëtar ishte i përzgjedhur deri në 14 borde ose komisione, ndërsa sipas UA nr. 12/2007, respektivisht nenit 4 të këtij UA specifikohet se një anëtar nuk mund të jetë me tepër se në një bord. Shuma vjetore e kompensimit për një anëtar ka arritur deri 17,880€. Disa nga anëtarët e bordeve edhe pse nuk ishin punonjës të MSH-së janë kompensuar në mënyrë retroaktive përmes payrollit.

Për më tepër vlera prej 4,200€, ishte paguar nga kategoria e subvencioneve për anëtarët e komisioneve.

Rreziku Pagesat për pjesëmarrje në borde dhe komisione janë në kundërshtim me nenin 80 të LMFPP ku përcaktohet se shërbyesit civil ose zyrtarët që caktohen në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, nuk kanë të drejtë të pranojë kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Poashtu caktimi në më shumë se një bord apo komision është në kundërshtim me udhëzimin administrativ të Qeverisë. Këto shkaktojnë shpenzime të parregullta dhe të pa arsyeshme për Ministrinë.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të rishikoj çështjen e funksionimit dhe pagesave të bordeve dhe komisioneve, në mënyrë që të përcaktohen masat e nevojshme për shmangien e pagesave të paarsyeshme. Të gjitha masat e propozuara duhet të jenë në harmoni me ligjet e aplikueshme dhe me synimet afatgjata të Ministrisë.

Çështja 13 - Dobësi në organizimin e burimeve njerëzore- Prioriteti – i mesëm

E gjetura Në QKUK dhe në AKPM kishte emërime në pozita të cilat nuk ishin të parapara me organogram. Po ashtu në këto janë bërë avancime në 12 raste në QKUK dhe në 15 raste në AKPM janë rritur koeficientët, jo në pajtim me rregulloret e aplikueshme.

Rreziku Dobësitë e lartëpërmenduara janë shkelje e dispozitave ligjore, krijojnë kosto shtesë dhe mund të ndikojnë negativisht në performancën e stafit që nuk është avancuar.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancimet e stafit dhe ngritja e pagave të jetë në pajtim me Ligjet e aplikueshme dhe politikat e Ministrisë.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Gjatë vitit 2013 ishin shpenzuar 4,763,603€, apo shprehur në përqindje 99,7% e buxhetit të kësaj kategorie. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve apo rreth 80%, përdoren për programin e trajtimit mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Procesi i menaxhimit të subvencioneve në përgjithësi ishte jo shumë efikas dhe si i tillë duhet të përmirësohet. Andaj ekziston nevoja për një trajtim të veçantë të gjendjes aktuale të trajtimit të pacientëve, në mënyrë që kjo gjendje të përmirësohet. Në veqanti nje ristrukturim i buxhetit do të duhej të konsiderohet duke i shtuar mjetet për zhvillimin e kapaciteteve për trajtimin e sëmundjeve që aktualisht nuk trajtohen në institucionet publike shëndetësore. Kjo do të zvogëlonte nevojën për subvencionim të trajtimeve jashtë këtyre institucioneve.

Rekomandimet

Çështja 14 - Trajtimi i pacientëve jashtë instuticioneve shëndetësore publike- Prioriteti i lartë

E gjetura Shuma prej 1,769,480€ ishte shpenzuar për trajtime mjekësore të pacientëve në dy institucione private shëndetësore në Kosovë - "International Hospital Medicine" dhe "Intermed-Eda". Trajtimi i pacientëve në këto institucione duhet bërë pas konfirmimit që nuk ka kushte për trajtim të sëmundjes në institucionet publike shëndetësore. Megjithatë në rastet e testuara gjetem se pacientët janë trajtuar pa një udhëzim të tillë. Ne kemi vërejtur edhe disa lëshime procedurale mirëpo për shkak të zhvillimit të procedurave hetimore për disa lëndë, nuk kemi mundur ti kompletojmë testimet.

Rreziku Mos funksionalizimi i plotë i njësive të caktuara në kuadër të QKUK-së përveç që shkakton shpenzime të tepërta për trajtimet mjekësore jashtë institucioneve publike, ndikon poashtu edhe në prishjen e imazhit të sistemit publik shëndetësor.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të sigurojë që të shfrytëzohen të gjitha kapacitetet aktuale dhe të zhvillohen kapacitete të reja në kuadër të Institucioneve shëndetësore publike për trajtimin e sëmundjeve që aktualisht trajtohën jashtë këtyre institucioneve. Kjo do të ndikoj në zvogëlim të kostove të këtyre shërbimeve dhe në ngritjen e reputacionit të sistemit publik shëndetësor.

Çështja 15- Mungesa e barazimeve financiare me Spitalet ku trajtohen pacientët - Prioritet i lartë

E gjetura Pacientët e trajtuar në spitalet jashtë institucioneve publike shpesh herë nuk i sjellin faturat dhe dëshmitë për shpenzimet e trajtimit. Një komision i formuar nga ana e Ministrisë gjatë vitit 2013 ka bërë barazimet financiare me disa institucione shëndetësore dhe si rezultat ka dalur se vetëm në dy institucione shëndetësore kishte 125,582€ të paguara për të cilat këto institucione nuk kanë ofruar shërbime.

Rreziku Mungesa e raportimeve për kostot e trajtimit të pacientëve, rrit dyshimin dhe mundësinë e keqpërdormit të këtyre mjeteve. Për shkak të mungesës së informatave nga ana e Ministrisë për ekzistimin e këtyre mjeteve të pashfrytëzuara, raste të rënda shëndetësore mund të mbeten pa u subvencionuar, dhe pacientët të pësojnë, duke marrë parasysh se buxheti për këtë kategori në krahasim me kërkesat është shumë i vogël.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të konsideroj mundësinë e adaptimit të një udhëzuesi të brendshëm/qarkore në lidhje me këto trajtime, duke specifikuar qartë kushtet dhe kriteret mbi barazimet e rregullta financiare pas trajtimit të pacientëve.

4.5 Pasuritë dhe obligimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Konkludojmë se MSH edhe me tej duhet të forcoj kontrollet për të siguruar menaxhim efikas dhe për të siguruar informata të sakta në lidhje me pasuritë. Kjo për faktin se regjistri kontabël nuk ishte i plotë dhe i saktë. Poashtu kishte diferenca në mes të informatave të stoqeve të paraqitura në PVF në krahasim me shënimet e brendshme. Prandaj harmonizimi i informatave të pasurisë edhe me tej mbetet sfidë për Ministrinë për të mundësuar inkorporimin e të gjitha informatave relevante në regjistrin e pasurisë dhe shpalosjen e tyre në PVF.

Përshkrim

Në përfundim të vitit 2013 MSH dhe instuticionet tjera vartëse shëndëtsore kishin formuar komisionet për të kryer inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në përputhje me rregullat relevante.

Vlera e pasurive jo-financiare kapitale (mbi 1000 Euro) të paraqitura në PVF-të 2013 janë në vlerë 229,822,753€. Mirëpo në kemi vërejtur në rexhistrin kontabël (SIMFK) nuk ishin evidentuar disa pajisje në vlerë prej 52,500€. Poashtu kishte diferenca tek informatat e stokut të barnave të prezantuar në PVF dhe gjendjes faktike të konstatuar nga komisioni për inventarizimin dhe regjistrim të pasurisë. Kjo diferencë ishte mbi 1,000,000€.

Rekomandimi

Çështja 16 – Mos-harmonizimi i regjistrit të pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura	MSH nuk ka arritur t'i konsolidojë të gjitha informatat rreth pasurive si pasojë e regjistrave jo të plotë dhe të saktë të Pasurive fikse në QKUK (ku kishte mos regjistrim të pajisjeve në vlerë prej 52,500€) dhe regjistrave jo të saktë të stoqeve tek Depoja Qendrore e Barnave (ku kishte mospërputhje të shënimeve)..
Rreziku	Mungesa e një regjistri të plotë të pasurive e vështirëson menaxhimin efikas dhe vendim-marrjen e menaxhmentit në lidhje me pasuritë dhe krijon vështirësi në shpalosjen e informatave të kërkuara në PVF.
Rekomandimi 16	Ministri duhet të siguroj ndërmarrjen e masave adekuate për harmonizimin e informatave rreth pasurive. Të gjitha pasuritë dhe stoqet duhet të evidentohen saktë dhe vlera e tyre të shpaloset në PVF.

4.5.2 Menaxhimi i automjeteve zyrtare

Përshkrim

Njësia e transportit ka bërë menaxhimin e automjeteve zyrtare, ka mbajtur shënime për shpenzimet e derivateve, riparimet dhe kilometrat e kaluara për secilin automjet zyrtar. Megjithatë, në dosjen e disa automjeteve kemi hasur mangësi informatash rreth përdorimit të tyre.

Rekomandimi

Çështja 17 – Evidencat e shfrytëzimit të automjeteve – Prioriteti i mesëm

E gjetura Nga testimi i përdorimit të automjeteve zyrtare kemi vërejtur se në katër nga veturat në SR Prizrenit nuk ishin mbajtur evidencat sipas kërkesave të udhëzimit administrativ.

Me një vendim të Ministrit ju është lejuar Këshilltarëve dhe dy zyrtarëve shfrytëzimi i automjeteve zyrtare gjatë 24 orëve, një vendim i tillë është në kundërshtim me nenin 3 të udhëzimit administrativ për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare UA- nr. 03/2008.

Rreziku Mungesa e raportimit për mënyrën e përdorimit të automjeteve, nuk krijon bazë të arsyeshme për shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet e Ministrisë, duke shkaktuar shpenzime të larta për derivate, servisim dhe mirëmbajtje të tyre.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të rishikoj vendimin për shfrytëzimin e automjeteve, për të siguruar arsyeshmërinë e tij dhe të vendosen kontrolle shtesë për shfrytëzimin e automjeteve duke siguruar që ato janë përdorur në pajtim të plotë me UA 03/2008. Të sigurohet llogaridhënie adekuate nga secili përdorues i automjeteve për të evituar përdorimin jo të rregullt të tyre.

4.5.3 Menaxhimi i Barnave

Konkluzioni

Konkludimi ynë është se Departamenti Farmaceutik i cili është përgjegjës për menaxhimin, e barnave të Listës Esenciale (LE), nuk ka arritur të sigurojnë menaxhim efikas të barnave. Shumë aspekte të këtij procesi kanë nevojë për përmirësim, duke filluar nga planifikimi, ruajtja e barnave dhe shpërndarja e tyre. Fakti që MSH në depon e barnave në fund të vitit 2013 sipas të dhënave nga Sistemi i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF) kishte mbi 3,5 milion Euro Material Medicinal dhe Barna me afat të skaduar tregon se kjo fushë ka nevojë për vëmendje më të madhe nga ana e menaxhmentit. Sfidë tjetër tek menaxhimi i barnave është mungesa e informatave të sakta rreth stoqeve të barnave. Në te ardhmen procesi i furnizimit me barna dhe produkte medicinale duhet të bëhet nga agjensionet përgjegjëse ndërkaq Ministria duhet të bëjë mbikqyrjen dhe rregullimin e menaxhimit të këtij aktiviteti në pajtim me synimet dhe planet e reformave shëndetësore.

Përshkrim

Për furnizim me barna të listës esenciale gjatë vitit 2013 ishin planifikuar 21,213,118€, ndërsa shpenzimet ishin 20,459,531.91€ (apo 97% të buxhetit). Departamenti Farmaceutik (DF), menaxhimin e Listës Esenciale e bënë me ndihmën e SMSF-së. Në SMSF evidentohën të gjitha hyrjet dhe daljet e barnave si dhe kërkesat on-line të institucioneve shëndetësore për furnizim me barna. Pas pranimit të këtyre kërkesave varësisht nga sasia në dispozicion bëhet aprovimi i kërkesave për të pasuar distribuimi i barnave. Testimet tona bërë procesit të menaxhimit të barnave kanë evidentuar disa mangësi të cilat të detajuara janë paraqitur më poshtë.

Rekomandimet

Çështja 18 - Diferenca në mes të informatave të stokut në SMSF dhe PVF - Prioritet i lartë

E gjetura	Vlera e stoqeve të prezantuara në PVF 14,580,691€. Në bazë të kalkulimeve tona të hyrjeve dhe daljeve të barnave në SMSF vlera e stoqeve duhet të ishte 13,887,549€. Prandaj ka një mbivlerësim të stoqeve për 693,142€. Përveq kësaj Ministria nuk kishte bërë rexhistrimin e rregulltë të barnave në depon qendrore dy herë në vit (çdo gjashtë muaj), siç kërkon udhëzimi administrativ.

Rreziku Mungesa e informatave të sakta në lidhje me stoqet e barnave ndikon në pasqyrim jo të saktë të tyre në PVF. Kjo poashtu ndikon në planifikimet për furnizimet e ardhme me barna.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të siguroj një menaxhim më efikas të stokut farmaceutik. Çdo hyrje dhe dalje e stokut duhet të evidentohet në SMSF. Për diferencat e shfaqura të formohet një komision i veçantë dhe të jepen sqarimet e duhura.

Çështja 19 - Regjistrime jo adekuate në sistemin SMSF - Prioritet i lartë

E gjetura Nga krahsimi i të dhënave të ofruara nga zyrtarët e MSH-së me ato që ne i kemi marrë gjatë auditimit të përkohshëm, vërehen diferenca që kalojnë shifrën e dy milion eurove. Kjo mund të ketë ndodhur si pasojë e mangësive të sistemit apo intervenimeve eventuale në SMSF.

Çdo hyrje e barnave në depo duhet të regjistrohet në sistemin SMSF. Ne kemi vërejtur se, edhe pse kishte pranim fizik të barnave në 55 raste faturat hyrëse (që janë regjistruar në sistem) ishin regjistruar me vlerë zero. Ka artikuj për të cilët në SMSF stoku fillestar dhe hyrjet e medikamenteve ishin zero, ndërsa kishte dalje me vlera të caktuara.

Si pasojë e përdorimit të faturave manuale ka rrjedhur një diferencë prej 79,865€ në mes të daljeve të barnave dhe materialit hargjues nga Depoja Qendrore dhe hyrjeve në Barnatoren e QKUK-së.

Kishte edhe raste kur barnat e pranuara nuk ishin rexhistruar në SMSF - donacionet nga projekti "HOPE" dhe donacionet nga Ambasada Italiane (materiali për Kardiokirurgjinë). Ndërsa blerjet nga UNICEF vëtem pjesa prej 122,210€ ishte evidentuar në SMSF kurse vlera totale e tyre ishte 413,509€.

Rreziku Ndryshimet në mes raporteve të hyrje-daljeve të produkteve medicionale në SMSF krijojnë pasiguri në lidhje me funksionimin e sistemit dhe njëherit krijojnë mundësinë e keqpërdorimeve të ndryshme. Kjo mund të sjell Ministrinë deri tek humbjet financiare si pasojë e keqpërdorimeve eventuale. Mos evidentimi i barnave në SMSF shkakton mungesë të informatave të sakta për to dhe vështirëson menaxhimin efektiv të tyre.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuara si çështje urgjente, për të identifikuar masat e nevojshme për sigurimin e regjistrimeve të sakta në sistemin SMSF për përmirësimin e sistemit aktual elektronik. Nevoja për një monitorim të funksionimit të SMSF-së, në baza të rregullta mujore të duhet merret në konsideratë.

Çështja 20 - Pranimi i barnave me afat më të shkurtër se një vit- Prioritet i lartë

E gjetura Sipas Udhëzimeve Administrative precizohet që afati i skadencës së barnave të pranuar duhet të jetë me i gjatë se një vit. Gjatë vitit 2013 Ministria kishte pranuar barna me afat më të shkurtër se 1 vjet me vlerë prej mbi 4,200,000€. Një pjesë e tyre ishin donacione.

Rreziku Pranimi i produkteve me afat të shkurtër të qëndrueshmërisë përveq që është shkelje e dispozitave administrative, shkakton rrijten e stoqeve me afat të skaduar, derisa kjo shkakton kosto shtesë për asgjësimin e tyre.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të rishikojë funksionimin e procesit të furnizimit me barna, në mënyrë që gjatë implementimit të reformave të evitohen dobësitë e identifikuara. Duhet të krijohen mekanizma adekuat që sigurojnë monitorim të procesit që nga planifikimi e deri tek shpërndarja e tyre tek pacientët. Praktika e pranimit të barnave me afat të shkurtë të qëndrueshmërisë duhet të ndërprehet me qëllim të zvogëlimit të kostove.

Çështja 21 – Çështje të planifikimit, aprovimit të kërkesave dhe distribuimit të barnave- Prioritet i lartë

E gjetura Testimet tona kanë evidentuar dobësi përgjatë procesit të furnizimit me barna si:

Mos harmonizim ndërmjet planifikimit dhe aprovimit të kërkesave për barna. Për QKMF Drenas ishin aprovuar barna më shumë se sa ishte kërkesa për 89%, derisa për QSHM në Gjakovë 25% më shumë. Kishte edhe raste kur ishin aprovuar më pak se sa kërkesa; QKMF në Deçan vetëm 76% e planifikimit ishte aprovuar, QKMF në "Viti" 73%.

Furnizimi me barna ishte i dobët nëse krahasohet më kërkesat. QSHM Ferizaj është furnizuar vetëm në masën 21% nga ajo që është aprovuar; në QSHM- Shtime me 27%; QKUK 65%, ndërsa SR në Prizren 78%.

Në fund të vitit 2013 në depon qëndrore ishin grumbulluar produkte medicinale dhe barna pa afat me vlerë të përafërt mbi 3.5 milion. Në rritjen e stokut me afat të skaduar, ka ndikuar mos aplikimi i metodës "FEFO" me rastin e distribuimit të barnave (I pari që skadon i pari del nga depoja). Në shtatë nga 15 artikujt e testuar nuk ishte respektuar kjo metodë.

Rreziku Mos furnizimi i rregullt me barna ndikon që institucionet shëndetësore të mos jenë në gjendje të ofrojnë shërbime cilësore për pacientët. Mos aplikimi i metodës adekuate gjatë distribuimit të barnave dhe materialit tjetër medicinal shkakton grumbullim të stoqeve me afat të skaduar dhe kjo pastaj krijon shpenzime shtesë për asgjësimin e tyre.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të siguroj aplikimin e politikave dhe procedurave që sigurojnë monitorim efikas të procesit të furnizimit me barna. Përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në ketë proces duhet të jenë të qarta për të mundësuar që procesi të jetë transparent dhe llogaridhënia të jetë në nivelin e duhur.

4.5.4 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2013, e prezantuar në PVF ishte në shumën 2,849,175 €. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës buxhetore të hasur nga MSH. Ka raste që faturat e pa paguara janë të muajve të hershëm, që nuk janë paguar me kohë. Kjo është pjesërisht si rezultat i kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme dhe pjesërisht çështje e prioritizimit të pagesave.

Rekomandimi

Çështja 22- Menaxhimi i detyrimeve dhe detyrimeve kontingjente –prioriteti i lartë

E gjetura Detyrimet në shumë prej 144,918€ dhe 10,928€, janë paguar drejtpërdrejt nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore, dhe kishin rrjedhë si detyrim që nga viti 2012. Këto nuk ishin prezantuar si detyrime apo detyrime kontigjente. Shuma 144,918€ ishte detyrim i SR Gjilanit derisa pjesa tjetër detyrim i Ministrisë.

Poashtu në SR Prizren faturat në vlerë prej 10,297€ si dhe 22,954€ ishin paguar në vitin 2013 por nuk ishin të prezantuar në PVF të vitit 2012.

Rreziku Mos kryerja me kohë e obligimeve mund të shkaktoj padi kundër Ministrisë, e kjo mund të rezultoj me kosto shtesë dhe ulje të reputacionit. Kur shumat janë materiale kjo sjell vështirësi në arritjen e objektivave. Ndërsa mos evidentimi i të gjitha detyrimeve shkakton nënvlerësimin e tyre në PVF.

Rekomandimi 22 Ministri duhet të rishikoj gjendjen e detyrimeve të papaguara dhe atyre kontigjente, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuara. Vlerësimi i detyrimeve duhet të bëhet në baza të rregullta mujore dhe pagesat të bëhen në bazë të vjetërsisë së tyre. Të gjitha obligimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente duhet të shpalosen në PVF.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzioni mbi Sistemin e Auditimit të Brendshëm

Aktiviteti dhe puna e kryer nga NJAB gjatë vitit 2013 nuk ishte e mjaftueshme për ti dhënë siguri menaxhmentit se të gjitha aktivitetet dhe sistemet e kontrolleve të brendshme kanë qenë efektive. Kjo për shkak se numri i stafit auditues në krahasim me kompleksitetin dhe shtrirjen e aktiviteteve që mbulon MSH është i vogël. Përveq kësaj edhe Komiteti i Auditimit (KA) për shkak të ndryshimit të përbërjes, nuk ka dhënë kontribut të mjaftueshëm në drejtim të përmirësimit të aktiviteteve dhe sistemeve të kontrolleve të brendshme. Një angazhim i shtuar i këtij komiteti është vërejtur në periudhën tremujore të fundvitit. ZAP ka dorëzuar një memorandum të veqantë të auditimit "Funksionimi i sistemit të Auditimit të brendshëm në Sektorin e Shëndetësisë dhe nevoja për përshtatjën e reformave" në Ministri duke dhënë alternativa për të ardhmën.

Përshkrimi

MSH e ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm (NjAB), e cila përbëhet nga udhëheqësi i njësisë dhe nga tre (3) zyrtar të auditimit, si dhe NJAB në QKUK e cila përbëhet nga udhëheqësi i njësisë dhe një zyrtar e auditimit.

Këto dy njësi kishin përgatitur planet vjetore të auditimit për vitin 2013, i cili ka përfshirë periudhën aktuale dhe fushat me rrezik. Gjatë vitit NjAB në MSH kishte përfunduar 15 raporte të auditimit, dhe NJAB në QKUK ka finalizuar pesë raporte. Ne i kemi shikuar raportet e auditimit të përfunduara nga NjAB dhe konkludojmë se janë evidentuar çështje dhe janë dhënë rekomandime të dobishme për menaxhmentin..

Rekomandimi

Çështja 23 – Mos-funksionalizimi i Komitetit të Auditimit - Prioritet i lartë

E gjetura	Komiteti i auditimit gjatë vitit 2013 ka pasur ndryshime në përbërje të anëtarëve, dhe në pjesën më të madhe të vitit, në bazë të procesverbaleve të mbajtura vërehet që nuk janë trajtuar dobësitë dhe rreziqet e raportuara nga NJAB.
Rreziku	Mungesa e kontributit të KA mund të rezultojë me mos adresim të rekomandimeve të auditorit të brendshëm, me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive.
Rekomandimi 23	Ministri duhet të siguroj që Komiteti i Audimit në Ministri është plotësisht operacional, në afat të shkurtër duke i ofruar asistencë në adresimin e rekomandimeve nga auditorët. Në afat të mesëm Ministri duhet të marrë parasysh organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në pajtim me një nga opcionet e propozuara nga Auditori i Përgjithshëm në Memorandumin "Funksionimi i auditimit të brendshëm në Sektorin e Shëndetsisë dhe nevojat për përshtatjn e reformave".

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotesisht të adresuara	Rekomandimet pjeserisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në PVF	Ministri duhet të sigurojë që plani i prodhimit të pasqyrave 2013 ta inkorporojë shqyrtimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti me theks të veçantë në plotësinë dhe saktësinë e informatave brenda PVF-ve. Duhet të bëhet shqyrtim specifik për të konfirmuar që shpenzimet që duhet të kapitalizohen janë llogaritur saktë.			Pasqyrat Financiare janë hartuar nga një grup punues mirëpo nuk janë rishikuar nga menaxhmenti i lartë para dërgimit në MF.
Rekomandimet e vitit paraprak	Të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës të fushave përkatëse.	I adresuar.		
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të siguroj rishikimin e proceseve ekzistuese të buxhetit për të përcaktuar përmirësimet që mund të bëhen për të siguruar rritjen e niveleve të ekzekutimit të buxhetit. Si pjesë e këtij procesi, MSH duhet që në mënyrë proaktive t'i monitorojë shpenzimet kapitale, të kërkojë në mënyrë aktive që t'i identifikojë dhe adresojë barrierat në përmirësimin e niveleve të ekzekutimit të buxhetit. Duhet t'i vihet theksi zbatimit të KASH-it dhe PIP-it sipas parashikimeve.		Niveli i ekzekutimit të buxhetit është përmirësuar në krahasim me vitin paraprak, mirëpo tek investimet kapitale ekzekutimi ishte i dobët. Poashtu edhe tek donacionet.	

Kërkesat aktuale për raportim	Ministri duhet të të zbatojë një planifikim efektiv të projekteve për t'u siguruar që janë përmbushur të gjitha kërkesa e raportimit të jashtëm. Ngjashëm, duhet të inkorporohet një shqyrtim rigoroz i udhëzimeve të MFK-së si një element kyç në planin e punës së departamentit të financave gjatë vitit 2013	I adresuar		
Te Hyrat	Ministri duhet të sigurojë që AKPM-ja të zbatojë harmonizime efektive në baza mujore nëpër të gjitha rrjedhat e të hyrave.			Ende ka diferenca të të hyrave në AKPM.
Të Hyrat	Ministri duhet ta udhëzojë QKUK-në dhe Spitalet Regjionale të konsiderojnë mundësinë për të zbatuar një softuer efektiv i cili i adreson dobësitë ekzsituese në regjistrimin manual. Në afat të shkurtër, duhet të merren në konsideratë shtimet potenciale të kontrolleve manuale mbi të hyrat si shtimi i kontrollimeve të mbikqyrjes, validimi i mostrave të të hyrave të paguara nga pacientët individualë etj. për ta konfirmuar plotësinë e të hyrës.		Janë shtuar kontrollet e brendshme sa i përket evidencencave të participimet, por një softuer efektiv ende mungon.	
Prokurimi	Ministri duhet të siguroj që janë shqyrtuar rastet e identifikuara në prokurim, të përcaktojë pse kanë ndodhur dështimet e identifikuara të prokurimit dhe të zbatojë kontrolle të shtuara për t'u siguruar që: Nuk ka konflikt të interesit gjatë fazave të ndryshme të prokurimit; Zbatimi i prokurimit siguron që janë pranuar ofertat më konkurruese për të siguruar arritjen e vlerës për para; dhe Vendimet e prokurimit të bëhen me kohë.			Disa nga dobësitë e identifikuara në vitin e kaluar janë përseritur

Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se aty ku ofertat e prokurimit janë të ngjashme, fituesi i tenderit të përcaktohet në bazë të referencave apo përvojave eventuale të mëhershme me OE-të dhe poashtu të sigurojë që; asnjë furnizim i bërë përmes prokurimit formal nuk duhet të paguhet pa ekzistimin e kontratës formale. Çfarëdo devijimi nga kjo qajse duhet të jetë subjekti i shqyrtimit të menaxhmentit për të përcaktuar pse ka ndodhur situata dhe për të identifikuar çfarë kontrolle duhet të shtohen për ta parandaluar përsëritjen e kësaj situate.	I adresuar		
Prokurimi	Të rishikohet rasti i identifikuar në lidhje me përdorimin e produkteve të cilësisë së ulët dhe të përcaktojë veprimet e nevojshme për të siguruar që janë pranuar zëvendësime të duhura brenda afatit adekuat. Aplikimi i ndëshkimeve të kontratave duhet të shqyrtohen si pjesë e këtij vlerësimi. Proceset që kërkojnë transferimin e fondeve ndërmjet projekteve duhet t'ju ritheksohen stafit.	I adresuar		
Qertifikimi i pagesave jo ne kode adekuate	Ministri duhet t'i shqyrtojë rastet e identifikuara të prokurimit ku pagesat janë bërë gabimisht dhe t'i përcaktojnë arsyet për dështimet e identifikuara, dhe kontrollet duhet të forcohen për t'u siguruar që pagesat jo të duhura të mos përsëriten. Aty ku është e nevojshme, duhet të ndërmerret trajnim shtesë i stafit për ta mbështetur këtë proces.			Ne nuk kemi marrur dëshmi se është bërë rishqyrtimi i rasteve në fjalë. Poashtu edhe ketë vit janë identifikuar shumë raste të keqklasifikimit të shpenzimeve.

Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë që stafi financiar i MSH-së të punojë me SR Gjakovë për ta përmirësuar raportimin e prokurimit, dhe me SR Prizren dhe SR Pejë për t'i pëmirësuar pranimet e mallrave. Duhet të shqyrtohet menaxhimi i stoqeve për të siguruar që janë zbatuar proceset efektive në sigurimin e kontrollit efektiv dhe përdorimit të barnave.		Raportimi është përmirësuar por menaxhimi i stoqeve mbetet sfidues.	
Shpenzimet tjera	Ministri duhet të sigurojë që kontratat për shërbime të trajnimeve të nëshkruhen para marrjes së shërbimit dhe të refletkojnë analiza paraprake të nevojave për trajnim. Pjesëmarrja e stafit në trajnime duhet të miratohet nga menaxhmenti.	I adresuar.		
Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha njësitë po zbatojnë kontrolle efektive mbi kujdestaritë me harmonizime të rregullta në mes të punës gjatë kujdestarive dhe pagesave të bëra, dhe të siguroj që pagesat e gatishmërisë janë autorizuar nga menaxhmenti. Vetëautorizimi i kujdestarive duhet të ndalet.	I adresuar.		
Pagat	Ministri duhet të sigurojë që stafi financiar i MSH-së të punojë me të gjitha njësitë për të siguruar që në të gjitha rastet është bërë kalkulimi i saktë i kujdestarive	I Adresuar		
Subvencionet(Pensionet Bazë dhe Kontributeve)	Ministri duhet të siguroj që të zbatohen kontrolle rreth subvencioneve dhe transfereve të cilat përfshijnë konfirmim nga pacientët mbi dëshmitë në dispozicion për t'i mbështetur pagesat – së paku në bazë të mostrave.		Bashkëpunimi me institucionet ku trajtohen pacientët ka filluar gjatë vitit por jo me të gjitha spitalet ku ishte bërë trajtimi.	

Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që është përfshirë një aktivitet specifik në planin e punës të departmentit të financave për vitin 2013 për të siguruar një harmonizim gjithëpërfshirës në mes të regjistrit të pasurive të MSH-së dhe atyre të njësive të saj dhe për të zbatuar një proces të vazhdueshëm të harmonizimit për të siguruar mirëmbajtjen e harmonizimit.		Ka një përmirësim tek menaxhimi i pasurive por rexhistri akoma nuk është i plotë.	
Trajtimi i borxheve	Ministri duhet t'i shqyrtojë arsyet për nivelin ekzistues të obligimeve të papaguara dhe të zhvillojë një plan veprimi për ta zvogëluar këtë nivel.		Niveli i obligimeve të është zvogëluar, por trajtimit të tyre duhet edhe me tej ti jepet trajtim i veçant, e sidomos detyrimeve kontigjente.	
Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë që KA zbaton efektivisht detyrat dhe përgjegjësitë e tij në vitin 2013 me theks të veçantë në të siguruarit që menaxhmenti ta zhvillojë cilësinë e NJAB-së dhe të implementojë aranazhime efektive për adresimin e rekomandimeve të saj.		KA në fund të vitit ka në rritje të angazhimit, por periudha më e gjatë ka qenë mjaft pasive, në realizimin e detyrave.	